

KONTRATA MIDIS PUNËDHËNËSIT DHE SHOQËRISË ADMINISTRUESE PËR ANËTARËSIMIN E PUNËMARRËSVE TË TIJ NË FONDIN E PENSIONIT PRIVAT ME PJESËMARRJE TË HAPUR SIGAL PRO PENSION

Mbështetur në nenet 659 e vijues të Kodit Civil të Republikës të Shqipërisë, në nenin 62 dhe 97 të ligjit nr.76/2023, "Për Fondet e Pensionit Privat", rregulloret e AMF-së si dhe akteve të tjera nënligjore të zbatueshme, sot më datë _____, në _____, nënshkruhet kjo kontratë me përfaqësuesit ligjorë të palëve si më poshtë:

PUNËDHËNËSI:

Shoqëria/subjekti _____, me seli _____ dhe zyrë qendrore _____, me (NUIS) _____ me përfaqësues ligjorë Z./ZJ. _____, _____, i cili kërkon të anëtarësojë punëmarrësit e saj në Fondin e Pensionit Privat me Pjesëmarrje të hapur SIGAL PRO PENSION për të marrë pjesë në fondin e pensionit privat me pjesëmarrje të hapur dhe me kontribute të përcaktuara në Republikën e Shqipërisë.

DHE

SHOQËRISË ADMINISTRUESE:

SIGAL UNIQA INVEST - Shoqëria Administrative e Fondeve të Pensionit Privat dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive sh.a. (në vijim Shoqëria Administrative) person juridik i themeluar në datë 21.01.2006 dhe i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit më datë 31.01.2006 me NUIS K61423001P, me seli në Rr. "Ukraina e Lirë", pas Kullave Binjake, midis Ambasadës së Kosovës dhe asaj Zvicerane (Pallati i Ri Teknoprojekt), Tiranë, me licencë nr. 2, datë 28.04.2022 lëshuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, e cila administron Fondin e Pensionit Privat me Pjesëmarrje të Hapur SIGAL PRO PENSION i miratuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare me Vendim Bordi nr. 251, datë 20.12.2022, përfaqësuar nga Z. ELVIS PONARI, Administrator. Fondi i Pensionit Privat me Pjesëmarrje të Hapur SIGAL PRO PENSION është fond pensioni privat me pjesëmarrje të hapur dhe me kontribute të përcaktuara në Republikën e Shqipërisë. Monedha bazë e fondit të pensionit privat me pjesëmarrje të hapur është Lekë.

Palët kontraktuese bien dakord si më poshtë:

Neni 1

Objekti dhe Qëllimi i Kontratës

- Objekt i kësaj kontrate është përcaktimi i të drejtave dhe detyrimeve të punëdhënësit dhe shoqërisë administrative për anëtarësimin e punëmarrësve të tij në Fondin e Pensionit Privat me Pjesëmarrje të Hapur SIGAL PRO PENSION (në vijim "Fondi").
- Qëllimi i lidhjes së kësaj kontrate është anëtarësimi i punëmarrësve në Fond.

NENI 2 BAZA LIGJORE

Kjo kontratë hartohet në përputhje të plotë me kuadrin ligjor në fuqi, si Kodin Civil, Ligjin nr.76/2023, datë 21.09.2023 "Për Fondet e Pensionit Privat" (në vijim ligji), aktet nënligjore të dala në zbatim të tij, si dhe rregulloret e brendshme të Shoqërisë Administrative.

Neni 3

Të Drejtat dhe Detyrimet e Punëdhënësit

- Pjesëmarrjen në Fond, punëdhënësi ua ofron të gjithë punëmarrësve.

- Punëdhënësi vetëm pasi zgjedh fondin me pjesëmarrje të hapur nëpërmjet nënshkrimit të kësaj kontrate me shoqërinë administrative, ka të drejtë të shpërndajë deklaratat e pranimi të pjesëmarrjes të punëmarrësit për nënshkrim. Punëdhënësi njofton shoqërinë administrative për nënshkrimin e deklaratës së pranimi të pjesëmarrjes nga punëmarrësi.
- Në cilësinë e punëdhënësit për punëmarrësit e tij, punëdhënësi merr përsipër detyrimin për të paguar kontribute mujore në shtesë të atyre të paguara për skemën e detyrueshme të Sigurimeve Shoqërore për të gjithë punëmarrësit e tij, në Fond.
- Punëdhënësi kryen pagesën e kontributeve për pension privat të punëmarrësve në nivelin e përcaktuar sipas deklaratës së pranimi të firmosur nga punëmarrësi të cilën e dërgon tek shoqëria administrative.
- Punëdhënësi bën ndalesat edhe të pjesës së kontributit që punëmarrësi merr përsipër të derdhë në fond dhe bashkë me pjesën e tij kryen pagesën e kontributeve.
- Punëdhënësi pas kryerjes së pagesës mujore të kontributeve për pensionin privat të punëmarrësve, paraqet çdo muaj pranë shoqërisë administrative skedulën e pagesave, në të cilën pasqyrohet e veçantë shuma e kontributit të paguar si nga punëmarrësi, ashtu dhe nga punëdhënësi i tij.
- Punëdhënësi zbret nga paga kontributin në emër të punëmarrësve, në përputhje me kërkesat ligjore dhe rregullatore si dhe ka detyrimin

për të vepruar në interesin më të mirë të pjesëmarrësve në fondin e pensionit.

8. Kontributet e paguara nga punëdhënësi ose çdo person tjetër në favor të punëmarrësit vlerësohen si kontribute të paguara nga vetë punëmarrësi. Punëdhënësi është përgjegjës ndaj punëmarrësve të vet për mos pagimin e kontributeve të parashikuara në këtë kontratë.

9. Punëdhënësi mund të kufizojë të drejtën e anëtarit për kontributet e paguara nga punëdhënësi, duke kërkuar që punëmarrësi të jetë i punësuar tek punëdhënësi për një periudhë të caktuar vitesh. Periudha përpara se punëmarrësit t'i njihet e drejta e përfitimit të kontributeve të paguara nga punëdhënësi nuk mund të jetë më e gjatë se pesë vjet, duke filluar nga dita kur është bërë pagesa e parë e kontributeve nga punëdhënësi.

Periudha përpara se punëmarrësit t'i njihet e drejta e përfitimit të kontributeve të paguara nga punëdhënësi është _____.

10. Për çdo shtim ose pakësim të numrit të të punësuarve në aktivitetin e tij, punëdhënësi është i detyruar të njoftojë paraprakisht shoqërinë administruese për punëmarrësit që do të bëhen pjesë e fondit të pensionit.

11. Punëdhënësi kërkon zbatimin e plotë të të gjitha detyrimeve që i lindin shoqërisë administruese nga zbatimi i akteve ligjore e nënligjore për administrimin e llogarive të anëtarëve si dhe për dhënien e përfitimeve personave të anëtarësuar.

12. Punëdhënësi i cili dëshiron të dalë nga Fondi është i detyruar të informojë me shkrim për këtë veprim, punëmarrësit anëtarë të fondit dhe shoqërinë administruese.

13. Punëmarrësi vazhdon të mbetet anëtar i fondit edhe në rastet kur punëdhënësi ka ndërprerë përkohësisht pagesën e kontributeve në llogarinë e tij personale. Aktivitetet në llogarinë e punëmarrësit vazhdojnë të investohen. Nga momenti kur punëdhënësi ndërpret pagesat për punëmarrësin e tij, punëmarrësi mund të zgjedhë: të vazhdoj kontributin nga ana e tij, të transferojë aktivet e veta në një fond pensioni tjetër i cili administrohet nga e njëjta ose nga një tjetër shoqëri administruese, apo të ruajë cilësinë e anëtarit të fondit pa kontribuar deri në momentin e lindjes së të drejtës për pension.

14. Punëmarrësi ka të drejtë që të vazhdojë anëtarësimin në fond edhe pas përfundimit të periudhës për të cilën është rënë dakord, pa një njoftim të veçantë me shkrim për shoqërinë administruese dhe pa marrë parasysh nëse janë paguar rregullisht kontributet në llogarinë e tij personale.

Neni 4

Të Drejtat dhe Detyrimet e Shoqërisë Administruese

1. Me nënshkrimin e deklaratës së pranimit të pjesëmarrjes, shoqëria administruese detyrohet të regjistrojë anëtarin në regjistrin e anëtarëve.

2. Shoqëria Administruese krijon për secilin anëtar një llogari individuale pensioni, në të cilën regjistrohen të gjitha pagesat e kontributeve të bëra nga ai vetë dhe nga punëdhënësi i tij, si dhe të gjitha interesat që grumbullohen në këtë llogari si rezultat i fitimit të arritur nga investimi.

3. Shoqëria administruese publikon në mënyrën dhe afatet kohore të përcaktuara në ligj, raportin vjetor të shoqërisë administruese, të ardhurat e fondit, kuotat, normën e fitimit, etj.

4. Shoqëria administruese informon në çdo kohë punëdhënësin dhe anëtarët për sa i përket ndryshimeve në politikat e investimit, si dhe rregulloret përkatëse nëpërmjet faqes zyrtare të shoqërisë administruese dhe në informacionet individuale që u dërgohen sipas afateve të caktuara çdo anëtar i fondit.

5. Shoqëria administruese merr përsipër të njoftojë tarifat e pjesëmarrjes dhe të administrimit të fondit. Çdo ndryshim i komisioneve dhe tarifave të zbatuara do t'u njoftohet anëtarëve, të paktën 6 (gjashtë) muaj përpara se ato të hyjnë në fuqi.

6. Shoqëria Administruese kryen transferimin e aktiveve, mbështetur në kërkesën me shkrim të Punëdhënësit dhe pas nënshkrimit të

deklaratës së pranimit të pjesëmarrjes nga punëmarrësi në fondin e ri të zgjedhur nga punëdhënësi, si në rastin e transferimit në një Fond tjetër të administruar nga e njëjta Shoqëri Administruese, ashtu edhe në rastin e transferimit në një Fond të administruar nga një tjetër Shoqëri Administruese.

7. Shoqëria Administruese ruan konfidencialitetin në lidhje me informacionin e dhënë nga punëdhënësi dhe punëmarrësi, si dhe të dhënat e llogarisë. Shoqëria Administruese është e detyruar të raportojë këtë lloj informacioni vetëm me kërkesë të organeve kompetente në përputhje me Legjislacionin Shqiptar.

Neni 5

Strategjia e Investimit Politika e Investimit

1. Aktivitetet e fondit do të investohen me synim për të rritur kthimin nga investimi për anëtarët e tij, nëpërmjet administrimit të kujdesshëm dhe konservator të rrezikut të investimit. Portofoli i fondit do të përbëhet kryesisht nga tituj afatgjatë të emetuar nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë.

2. Politika e investimit paraqitet në Prospektin e fondit bashkëlidhur kësaj kontrate dhe e publikuar në faqen zyrtare të Shoqërisë Administruese.

3. Aktivitetet e fondit do të investohen sipas parimit të sigurisë afatgjatë dhe të një kthimi të përshtatshëm nga investimi, duke ruajtur një raport optimal mes rritjes së kursimeve për pension dhe riskun të marrë përsipër.

4. Aktivitetet e fondit do të investohen në instrumenta të sigurtë dhe ku një pjesë e të cilave do të jetë likuide.

5. Portofoli i fondit do të përbëhet kryesisht nga tituj afatgjatë (me maturim më të gjatë se një vit) të emetuara dhe/ose garantuara nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë. Pjesë përbërëse e portofolit do të jenë edhe titujt e borxhit afatshkurtër të emetuara dhe/ose garantuara nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë si dhe titujt të borxhit të emetuara nga bankat dhe institucione financiare jo bankare, që nuk janë pranuar për tregtim në një treg të rregulluar

6. Shpërndarja strategjike e aktiveve për Fondin paraqitet si më poshtë:

Tituj të Qeverisë Shqiptare – (99 % +/-1%)
Mjete Monetare, ekuivalentë të tyre & Depozita në banka të licencuara nga BSH – (1 % +/-1 %)
Në total vlera të titujve të borxhit, të emetuara nga bankat dhe institucione financiare jo bankare, që nuk janë pranuar për tregtim në një treg të rregulluar 5% <=

7. Investimi në aktive financiare shoqërohet gjithmonë me rrezik duke qenë se rreziku nuk mund të shmanget asnjëherë plotësisht. Çdo aktiv financiar përmban një kombinim midis rrezikut dhe normës së kthimit, ku sa më i lartë të jetë rreziku aq më e lartë mund të jetë norma e kthimit. Fondi i Pensionit është me kontribute të përcaktuara ku përfitimet nuk janë të garantuara, anëtar i pasiguar me këtë kontratë dhe prospektin e Fondit, merr përsipër riskun e investimit të Fondit.

Neni 6

Depozitari

1. Shoqëria administruese ka lidhur marrëveshje për shërbimin e Depozitarit me bankën "Bankën Kombëtare Tregtare" sh.a me NUIS J62001011Q dhe me seli në adresën: Rruga e Vilave, Lundër 1, 1045, Tiranë, Shqipëri. Kjo bankë, në përputhje me ligjin nr.76/2023 "Për Fondet e Pensionit Privat" do të ofrojë shërbimet e kujdestarisë, të depozitimit dhe të besimit për aktivet e fondit.

2. Depozitari "Banka Kombëtare Tregtare" sh.a është një entitet ligjor i rregulluar, licencuar dhe mbikëqyrur nga Banka e Shqipërisë sipas licencës me nr. 6/1998, datë 11.01.1999 dhe licencën si Depozitar i Fondit të Pensioneve nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, me nr. 4 datë 21.12.2015.

3. Depozitari do të jetë përgjegjës për ruajtjen e aktiveve në fond. Depozitari kontrollon administrimin e aktiveve të fondit nga Shoqëria Administruese në përputhje me dispozitat e kontratës, prospektin si dhe të legjislacionin në fuqi.

4. Depozitari është një entitet tërësisht i pavarur nga Shoqëria Administruese dhe çdo palë tjetër e lidhur me të, i cili siguron që të gjitha të ardhurat e fondit do të shpërndahen në përputhje me ligjin dhe kontratën.

Neni 7

Vlera Neto e Aktiveve dhe Vlera Neto e Aktiveve për Kuotë

1. Vlera totale e aktiveve të fondit të pensionit, në ditën e vlerësimit*, është shuma e vlerave të të gjitha llojeve të aktiveve të lejuara nga ligji dhe aktet nënligjore.

2. Vlera neto e aktiveve të fondit të pensionit, në ditën e vlerësimit (t-1), rezulton nga diferenca ndërmjet vlerës totale të aktiveve të fondit të pensionit në ditën (t-1), me totalin e detyrimeve të fondit të pensionit të po asaj dite (t-1).

Pagesat në formë kontributi të bëra në llogarinë personale të anëtarit, si dhe aktivet e transferuara në fond, do të shndërrohen në kuota pensioni në ditën e mbërritjes së pagesës në llogarinë e fondit me çmimin e kuotës të ditës së mbërritjes së pagesës.

Kontributet e derdhura në fondin e pensionit për tu konvertuar në kuota, pjesëtohen me vlerën e aktiveve për kuotë të po asaj dite (t).

3. Procedura e detajuar e konvertimit të kontributeve të paguara nga anëtarit në kuota përcaktohet në Prospektin e Fondit të hartuar nga shoqëria administruese.

4. Çmimi i kuotës në ditën e vlerësimit (t-1) llogaritet duke pjesëtuar vlerën neto të aktiveve të fondit të pensionit të ditës (t-1) me numrin total të kuotave të fondit të pensionit të po asaj dite (t-1).

5. Numri total i kuotave të fondit të pensionit, në ditën e vlerësimit (t-1), llogaritet duke i shtuar numrit të kuotave të pensionit të ditës (t-2), numrin e kuotave që fondi i pensionit emeton për anëtarët gjatë ditës (t-1) si dhe duke zbritur numrin e kuotave të shlyera nga fondi i pensionit në formën e pagesave për pension, tërheqjeve të parakohshme dhe të transferuara në një fond tjetër, në ditën (t-1). 6. Kuotat e pensionit të emetuara dhe të tërhequra nga fondi i pensionit regjistrohen në llogaritë personale të anëtarëve të fondit në të njëjtën ditë të emetimit apo tërheqjes.

**Ditë vlerësimi nënkupton ditën "t" në të cilën bëhet përlogaritja e vlerës neto të aktiveve të fondit të pensionit mbështetur në të dhënat e mbylljes së një dite më parë "t-1".*

Neni 8

Transferimi i Aktiveve të punëmarrësit

1. Punëmarrësi anëtar i fondit të pensionit ka të drejtë të transferojë aktivet e depozituara nga punëdhënësi në llogarinë e tij në një fond tjetër pensioni, të administruar nga e njëjta shoqëri administruese ose nga një shoqëri administruese tjetër, me përfundimin e marrëdhënies kontraktuale të punës mes punëmarrësit dhe punëdhënësit, por jo më përpara se punëmarrësit t'i njihet e drejta e përfitimit të kontributeve të paguara nga punëdhënësi (jo më shumë se 5 vite nga kontributi i parë).

2. Anëtarit, me përmbushjen e kërkesave të pikës 1 të këtij neni, ka të drejtë:

a) të ruajë cilësinë e anëtarit të fondit pa kontribuar deri në momentin e lindjes të së drejtës për pension;

b) të transferojë vlerën e aktiveve në llogarinë personale tek një fond tjetër pensioni i hapur;

c) të transferojë vlerën e aktiveve në llogarinë personale tek një fond tjetër pensioni me pjesëmarrje të hapur, të përzgjedhur nga punëdhënësi i ri me të cilin ka lidhur kontratë/marrëdhënie pune, i

administruar nga e njëjta shoqëri administruese, ose nga një shoqëri administruese tjetër.

4. Në rastin e transferimit të aktiveve të anëtarit në një shoqëri tjetër administruese, shoqëria administruese me marrjen e kërkesës me shkrim dhe dokumentacionit përkatës nga anëtarit për të transferuar aktivet, njofton brenda 5 ditëve pune shoqërinë tjetër administruese për kërkesën e anëtarit për transferimin e aktiveve.

5. Shoqëria administruese ekzekuton transferimin e aktiveve në llogari brenda 10 ditëve pune nga data e marrjes së konfirmimit të shoqërisë administruese tjetër.

6. Në rastin e transferimit brenda të njëjtës shoqëri administruese, transferimi ekzekutohet brenda 5 ditëve pune nga data e marrjes së kërkesës nga anëtarit.

7. Brenda 5 ditëve pune nga dita e transferimit të llogarisë, shoqëria administruese informon anëtarin për ekzekutimin e transferimit, vlerën totale neto të aktiveve të transferuara, përfshirë kthimin nga investimi, si dhe detyrimet e zbritura.

Neni 9

Tarifa e Shoqërisë Administruese

1. Shoqëria administruese në zbatim të ligjit nr.76/2023 "Për Fondet e Pensionit Privat" si dhe të rregullores së Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, zbaton këto tarifa:

a) për tarifën e administrimit të fondit të pensionit 1.5% (një pikë pesë përqind) në vit të vlerës neto të aktiveve të fondit të pensionit dhe kjo është tarifa e vetme që i mbahet Fondit;

b) për transferimin e aktiveve të anëtarit nga fondi i pensionit ekzistues në një fond të ri pensioni, aplikohet tarifa e transferimit e cila është 0.5% (zero pikë pesë përqind) e shumës së transferuar;

c) tarifa e administrimit të fondit i ngarkohet aktiveve të fondit në fund të çdo dite dhe mbahet në fund të çdo muaji si shumë e vlerës ditore për atë muaj;

d) për tërheqjet e parakohshme të pensionit anëtarët e fondit të pensionit paguajnë penalitete si më poshtë:

- 5 % të aktiveve të tërhequra pas 20 vitesh nga dita e pagesës së kontributit të parë;

- 10 % të aktiveve të tërhequra pas 10 deri 20 vite nga dita e pagesës së kontributit të parë;

- 15 % të aktiveve të tërhequra pas 5 deri 10 vite nga dita e pagesës së kontributit të parë;

- 20 % të aktiveve të tërhequra deri 5 vite nga dita e pagesës së parë të kontributeve.

Në rastin e vdekjes së Anëtarit të Fondit nuk aplikohet penalteti i tërheqjes së parakohshme.

2. Përveç tarifave të përmendura më lart, anëtarit i Fondit të Pensionit është i detyruar që të kompensojë shoqërinë administruese për të gjitha shërbimet shtesë të ofruara sipas kërkesës së anëtarit (si për shembull: shpenzime të ndryshme bankare, shpenzimet postare, etj.)

3. Çdo rritje e komisioneve dhe tarifave të zbatuara nga Shoqëria Administruese, brenda kufijve të përcaktuar me ligj, u njoftohet anëtarëve, të paktën, 6 (gjashtë) muaj përpara se ato të hyjnë në fuqi.

Neni 10

Trajtimi Fiskal

Kontributet e bëra nga punëdhënësi në interes të punëmarrësve të tij në një fond pensioni vlerësohen shpenzim operativ deri në shumën vjetore për çdo punëmarrës, të barabartë me pagën minimale vjetore të miratuar në shkallë vendi, dhe kjo shumë vlerësohet shpenzim i njohur për qëllime të tatimit mbi fitimin.

Neni 11

Dispozita të Përbashkëta

1. Nëse secila nga palët nënshkruese të kësaj kontrate kërkon të tërhiqet nga zbatimi i saj, atëherë ajo është e detyruar të njoftojë palën tjetër brenda një afati jo më pak se tre muaj nga data që ka vendosur të tërhiqet.

2. Nëse tërheqja nga zbatimi i kontratës vjen si rezultat i shkrirjes, i bashkimit, i ndarjes apo i mbylljes së aktivitetit të secilës palë nënshkruese, atëherë kompensimi i anëtarëve të fondit. të cilët nuk ishin shkaktarë të ndërprerjes së kontratës, bëhet sipas Legjislacionit të Republikës së Shqipërisë.

Neni 12

Kufizimet e Sanksioneve dhe Klauzola Përfunduese

Pavarësisht dispozitave të tjera të kësaj kontrate, kjo kontratë nuk është në kundërshtim me asnjë sanksion ekonomik, tregtar ose financiar dhe/apo embargo të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (KB), të Bashkimit Evropian (BE), ose ndonjë ligji apo legjislacioni vendor i aplikueshëm për palët e kësaj kontrate. Kjo klauzolë gjithashtu është e aplikueshme edhe për sanksionet ekonomike, komerciale ose financiare dhe/ose embargo të lëshuara nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës ose vendeve të tjera, për aq sa nuk bien ndesh me legjislacionin e Bashkimit Evropian (BE) ose legjislacionin vendor.”

Neni 13

Kohëzgjatja e Kontratës

1. Kjo kontratë lidhet për një afat të pacaktuar dhe sjell pasoja ligjore vetëm pasi të jetë kryer pagesa e parë e kontributit, sipas metodës së rënë dakord mes palëve.

2. Kontrata do të përfundojë me kërkesën e çdonjërës nga palët për zgjidhje të njëanshme, në rastin kur kemi shkelje të dispozitave të kësaj kontrate, por në çdo rast duke aplikuar njoftimin me shkrim 3-muaj përpara përfundimit të marrëdhënies kontraktuale.

SIGAL UNIQA INVEST- Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit Privat dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive sh.a.
ADMINISTRATOR
ELVIS PONARI

(emër, mbiemër)

(nënshkrimi)

Neni 14

Ndërprerja e Kontratës

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve që mund të lindin nga zbatimi i kësaj kontrate, bëhet me mirëkuptim midis palëve ose në rast të kundërt, çdo palë ka të drejtë t'i drejtohet gjykatës së rrethit gjyqësor.

Neni 15

Dispozitat Përfundimtare

1. Ndryshimet në kontratë bëhen me mirëkuptimin e palëve, nënshkruese të saj. Çdo ndryshim i kontratës miratohet nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

2. Kjo kontratë hartohet në gjuhën shqipe në dy kopje identike, nga një për secilën palë nënshkruese.

3. Për sa më sipër Autorizoj Shoqërinë Administruese për përpunimin e të dhënave personale, në përputhje me ligjin nr. 9887, datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”. Me përpunim të dhënash në kontekstin e këtij autorizimi bazuar në Ligjin nr.9887, datë 10.03.2008, kupto “grumbullimin, regjistrimin, ruajtjen, renditjen, përshtatjen, ndreqjen, këshillimin, shfrytëzimin, përdorimin, bllokimin, fshirjen ose shkatërrimin, transmetimin” etj.

4. Autorizoj Shoqërinë Administruese për deklarimin e të dhënave të mia personale, pranë institucioneve përkatëse të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

5. Kontrata midis punëdhënësit dhe shoqërisë administruese për anëtarësim të punëmarrësve të tij në fondin me pjesëmarrje të hapur, shoqërohet me një kopje të prospektit të fondit.

Neni 16

Hyrja në Fuqi

Kjo kontratë hyn në fuqi me nënshkrimin e saj nga të dyja palët.

Subjekti/Shoqëria

(emër, mbiemër)

(nënshkrimi)